L I G J
Nr. 8957, datë 17.10.2002

PËR NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky ligj rregullon masat dhe politikat shtetërore për klasifikimin, nxitjen e krijimit dhe të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është të ndihmojë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, nëpërmjet krijimit të një kuadri institucional, rregullator dhe financiar.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji:
"Xhiro ekonomike vjetore" nënkupton shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë një viti, që i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.
"Mikrokreditim" nënkupton kreditimin e mikrondërmarrjeve deri në vlerën prej
2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh.

Neni 4

1. Ndërmarrjet, në kuptim të këtij ligji, klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.
2. Mikrondërmarrjet janë ndërmarrjet, të cilat punësojnë deri në 5 punonjës.
3. Ndërmarrjet e vogla janë ndërmarrjet, të cilat:
a) punësojnë 6-20 punonjës;
b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 40 milionë lekë;
c) 100 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të këtij ligji, klasifikohen si ndërmarrje të vogla.
4. Ndërmarrjet e mesme janë ndërmarrjet, të cilat:
a) punësojnë 21-80 punonjës;
b) xhiroja ekonomike vjetore e tyre nuk e kalon shumën 80 milionë lekë;
c) më pak se 25 për qind e kapitalit të këtyre ndërmarrjeve zotërohet nga subjekte, të cilat, në kuptim të këtij ligji, nuk klasifikohen si ndërmarrje të vogla dhe të mesme.

KREU II

MASAT PËR NXITJEN E KRIJIMIT DHE TË ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 5

Këshilli i Ministrave mbështet krijimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet:

a) sigurimit të programeve dhe projekteve të ndryshme të mbështetjes financiare;

b) garantimit të një pjese të riskut të kreditimit;

c) zhvillimit dhe zbatimit të programeve e projekteve të asistencës teknike;

ç) shërbimeve të informacionit dhe këshillimit;

d) arsimimit, trajnimit për kualifikimin profesional, si dhe ngritjes së aftësive sipërmarrëse;

dh) programeve të nxitjes së punësimit;

e) dhënies me qira të pasurive të paluajtshme me pronësi shtetërore;

ë) ngritjes së infrastrukturës në mbështetje të këtyre ndërmarrjeve dhe nxitjes së bashkëveprimit ndërmjet tyre;

f) ngritjes së parqeve industriale dhe inkubatorëve të biznesit për zhvillimin e këtyre ndërmarrjeve;

g) veprimtarive dhe masave të tjera në përfitim të tyre, të përcaktuara me ligj.

Neni 6

1. Në kuptim të nenit 5 të këtij ligji, mbështeten me përparësi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat:

a) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët prodhues dhe të shërbimit;

b) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e industrisë;

c) krijojnë vende të reja pune;

ç) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prodhimin për eksport;

d) ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e turizmit;

dh) zhvillojnë veprimtaritë në fushën e kërkimit dhe të zhvillimit;

e) ushtrojnë veprimtaritë e tyre në procesin e agropërpunimit;

ë) zhvillojnë veprimtarinë në sektorin e artizanatit.

2. Gëzojnë të drejtën e mbështetjes me përparësi të gjitha bizneset, të cilat janë në fillim të veprimtarisë së tyre dhe që zhvillojnë veprimtari në fushat e përcaktuara sipas këtij neni.

KREU III
FUSHAT E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NXITJEN E VEPRIMTARISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 7

1. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, siguron fonde:

a) për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve dhe të programeve;

b) për organizimin e kurseve të trajnimit dhe të seminareve;

c) për shërbimet e informacionit dhe këshillimit, nëpërmjet botimit të materialeve të ndryshme informative.

2. Fondet e përmendura në pikën 1 të këtij neni administrohen nga Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, e cila parashikohet në kreun V të këtij ligji.

Neni 8

Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me donatorët, institucionet financiare, të vendit ose të huaja, të përmirësojë sistemin e kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke ndërmarrë nisma të "mekanizmave financiarë" në këto drejtime:

a) në krijimin e fondit të garantimit të kredive;

b) në nxitjen e zgjerimit të mikrokreditimit dhe të kreditimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;

c) në krijimin e instrumenteve të tjera financiare, duke zgjeruar rrjetin bankar në të gjithë vendin.

KREU IV
PROGRAMET PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 9

Ministritë dhe institucionet përkatëse parashikojnë në programet e tyre dhe zbatojnë masa në drejtim:

a) të krijimit të vendeve të reja të punës;

b) të zgjerimit të veprimtarive eksportuese dhe të rritjes së konkurrencës ndërmjet tyre;

c) të nxitjes së investimeve;

ç) të përmirësimit të shërbimeve të të dhënave dhe të këshillimit;

d) të rritjes dhe forcimit të kualifikimit profesional dhe të aftësive sipërmarrëse;

dh) të mbështetjes dhe zgjerimit të numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, të cilat zbatojnë teknologji të përparuara;

e) të mbështetjes së ndërmarrjeve, të cilat janë potencial për zbatimin e standardeve të cilësisë (ISO);

ë) të mbështetjes së ndërmarrjeve që zbatojnë forma të reja programesh trajnimi e punësimi pranë vendit të punës.

Neni 10

1. Institucionet qendrore dhe ato të pushtetit vendor, brenda kompetencave të tyre, zhvillojnë programe:

a) afatmesme dhe afatgjata për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në territoret e tyre përkatëse;

b) për trajnimin dhe përmirësimin e nivelit të kualifikimit të menaxherëve dhe të punonjësve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në bashkëpunim me organizatat e biznesit dhe institucionet publike, dhomat e tregtisë dhe industrisë, agjencitë rajonale të zhvillimit të biznesit, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe me organizatat e tjera.

2. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni të bashkërendohen nga Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme.

Neni 11

Ministria e Ekonomisë përcakton kriteret për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këto programe, sipas neneve 9 dhe 10 të këtij ligji.

KREU V
KRIJIMI I AGJENCISË SË NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Neni 12

Për zbatimin e politikave dhe të strategjive, si dhe për zhvillimin e programeve dhe projekteve në mbështetje të zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, krijohet Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, e cila më poshtë do të quhet Agjencia.

Neni 13

Detyrat, organizimi, buxheti dhe varësia e Agjencisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Ministria e Ekonomisë, Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Instituti i Statistikave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe institucionet në varësi të tyre, sipas përkatësisë, mbledhin dhe përpunojnë informacionin dhe të dhënat për veprimtarinë ekonomike dhe financiare, sipas përcaktimeve në nenin 4 të këtij ligji.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe institucionet përkatëse të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe për rregullimin e marrëdhënieve të parashikuara në nenet 8, 11, 13 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3547, datë 7.11.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu